

Data __.07.2024.

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Tiranë, me afat 24 muaj dhe Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Kavajë, me afat 24 muaj, e ndarë në 2 lote - Marrëveshje kuadër me disa Operatorë Ekonomikë (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
50800000-3.**

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/Vlera e pritshme e Kontratave e parashikuar për periudhën 24 (njëzet e katër) muaj për Loti 1 dhe Loti 2 është: 2,796,010 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dhjetë) lekë pa TVSH:

Fondi Limit për Lot 1: “Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Tiranë është: 1,998,350 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH

Fondi Limit për Loti 2 “Riparim – mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Kavajë është: 797,660 (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Shumatorja e çmimeve per njësi (në total për të gjitha lotet): **158,820** (njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa TVSH, e ndarë si më poshtë:

Loti 1: 103,500 (njëqind e tre mijë e pesëqind) lekë pa TVSh;

Loti 2: 55,320 (pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet) lekë pa TVSh.

Lot 1: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Tiranë:


Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.v. elektromotorri krevati tip erpa	Copë	20
2	F.v. Pult krevati tip erpa	Copë	100
3	Riparim – mirembajtje freni	Copë	16

4	Riparim–mirembajtje i suportit metalik ballor te krevatit tip erpa	Copë	10
5	Riparim - mirembajtje krevati(defekte te ndryshme)	Copë	40
6	Riparim karroce pacienti	Copë	20
7	Riparim mirembajtje barrele pacienti te autoambulancave	Copë	10
8	F.V. rrota krevatesh tip erpa	Copë	40
9	Riparim – mirembajtje tavoline ngrënie pacienti	Copë	85
10	F.v. elektromotorri krevati tip SCHRODER	Copë	8
11	F.v. Pult krevati tip SCHRODER	Copë	12
12	Riparim - mirembajtje krevate tip SCHRODER	Copë	6
13	F.V. rrota krevatesh tip SCHRODER	Copë	20

Loti 2: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Kavajë:

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.V. i strukturese se rrotes se krevatit te pacientit (rrota frenuese)	Copë	40
2	F.V. i strukturese se rrotes se krevatit te pacientit (rrota te thjeshta)	Copë	40
3	Saldim te shtratit te krevatit te pacientit	Copë	12
4	Lyerje komplet te shtratit te pacientit	Copë	12
5	Riparim komplet tavoline ngrënie te pacientit	Copë	14
6	Riparim komplet komedine te pacientit	Copë	24
7	Riparim karroce te pacientit	Copë	5
8	Riparim i shtratit te pacientit	Copë	4
9	Riparim i rrotave te shtratit te pacientit	Copë	14
10	Riparim tavolina per shperndarjen e ushqimit (me rrota te levizshme)	Copë	4
11	Riparim i barrelave te pacientit	Copë	2
12	Riparim i rafteve te pacientit (teke)	Copë	6
13	Riparim i rafteve te pacientit (dyshe)	Copë	4

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Q.S.R.T ”Shefqet Ndroqi”, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

 **Loti 1: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)** në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi”, Njësia Tiranë:

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: **Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë e kriterëve plotësohet me kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të plotësuar më lart.

2.1.1.a) Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.1.1.b) Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 45001:2018** (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma

nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi i kriterëve

- Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.** Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. **Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:**

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Argumentimi i kriterit

Në bazë të nenit 77/ 1/ a , dhe 77/ 2 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) **përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;**
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2021; 2022; 2023 ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave për secilin lot për të cilin oferton të kësaj Procedure Prokurimi.**

Shënim:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilin ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence"; Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomik dhe financiar per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" ne piken 2.10 / 2.14.**

-Kur konkurohet për më shumë se një lot, vlera prej 20 % do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor Q.S.R.T "Shefqet Ndroqi" Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Kërkoheq që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën deri në **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 2 (dy) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët: **1 (një) elektrikist dhe 1 (një) punëtor mirëmbajtje**. me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi 2 – (dy) punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe
- Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:
 - **Minimumi 1 (një) elektrikist;**
 - Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:
 - *CV përkatëse;*
 - *Kopje e noterizuar e çertifikatës ose dëshmsë përkatëse;*
 - *Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me elektrikistin.*
 - **Minimumi 1 (një) punëtor mirëmbajtje;**
 - Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:
 - *Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me elektrikistin.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart orgjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

Argumentimi I kriterit

Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 139/9 prot.,date 19.04.2024 për procedurën e prokurimit me *“Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)”* në Q.S.R.T. *“Shefqet Ndroqi”*njësia Tiranë, me afat 24 muaj dhe *Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti dhe barrele)”* në Q.S.R.T. *“Shefqet Ndroqi”*njësia Kavajë, me afat 24 muaj.e ndarë në 2 lote- Marrëveshje kuadër me disa Operatorë

Ekonomikë (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”. . nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.139 prot, datë 19.03.2024 dhe nr.139/1 prot, datë 25.03.2024 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njesisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike.Gjithashtu,Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Neni 41/4 b dhe c i VKM nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

2.3.3: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 2 (dy) persona**, punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e

përcaktuar më lart orgjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

Argumentimi pika 2.3.3:

Ky kriter u vendos në mbështetje të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike të Relacionit nr. 139/9 prot., datë 19.04.2024 për procedurën e prokurimit me *“Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)”* në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi” Njësia Tiranë, me afat 24 muaj dhe *Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)”* në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi” Njësia Kavajë, me afat 24 muaj, e ndarë në 2 lote - Marrëveshje kuadër me disa Operatorë Ekonomikë (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”. nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.139 prot, datë 19.03.2024 dhe nr.139/1prot, datë 25.03.2024 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njesisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 41/4 b i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

d) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

e) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar, kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

2.3.4: Autodeklarate nga ofertuesi që të gjitha materialet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të certifikuara (CE).

Argumentimi i kriterit

Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 dhe 2 gj) të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1: (nuk është i aplikueshëm).

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim në vëmendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.

- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

✚ Loti 2: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti dhe barrele)” në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi”Njësia Kavajë.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: **Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë e kriterëve plotësohet me kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të plotësuar më lart.

2.1.1.a) Operatori duhet të ketë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.1.1.b) Operatori, duhet të ketë çertifikatën **ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë te punëtorve në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi i kritereve

- Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:**
 - a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
 - b) efijencës së energjisë;
 - c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Argumentimi i kriterit

Në bazë të nenit 77/ 1/ a , dhe 77/ 2 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) **përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;**
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet financiare të fundit nga data e hapjes së ofertave: 2021; 2022; 2023 ku vlera e xhiros vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave për secilin lot për të cilin oferton të kësaj Procedure Prokurimi.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilin ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në perputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rasteve të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulent”; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara më poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.**

-Kur konkurohet për më shumë se një lot, vlera prej 20 % do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi” është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në

shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Kërkohej që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën deri në **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 2 (dy) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët: **1 (një) elektrikist dhe 1 (një) punëtor mirëmbajtje**. me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku të pasqyrohen minimumi 2 – (dy) punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe

- Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

• **Minimumi 1 (një) elektrikist;**

- Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

- *CV përkatëse;*

- *Kopje e noterizuar e certifikatës ose dëshmsë përkatëse;*

- *Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me elektrikistin.*

• **Minimumi 1 (një) punëtor mirëmbajtje;**

- Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

- *Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me elektrikistin.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”*

Argumentimi i kriterit

Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 139/9 prot.,date 19.04.2024 për procedurën e prokurimit me “Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi”njësia Tiranë, me afat 24 muaj dhe Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti dhe barrele)” në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi”njësia Kavajë, me afat 24 muaj,e ndarë në 2 lote- Marrëveshje kuadër me disa Operatorë Ekonomikë (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”. . nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.139 prot, datë 19.04.2024 dhe nr.139/1 prot, datë 25.03.2024 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njesisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike.Gjithashtu,Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Neni 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Neni 41/4 b dhe c i VKM nr. 285, date 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

f) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

2.3.3: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 2 (dy) persona**, punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e

përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Argumentimi pika 2.3.3:

Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike Relacionit nr. 139/9 prot.,date 19.04.2024 për procedurën e prokurimit me *“Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)”* në Q.S.R.T. *“Shefqet Ndroqi”* njësia Tiranë, me afat 24 muaj dhe *Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti dhe barrele)”* në Q.S.R.T. *“Shefqet Ndroqi”* njësia Kavajë, me afat 24 muaj.e ndarë në 2 lote- Marrëveshje kuadër me disa Operatorë Ekonomikë (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”. nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesave nr.139 prot, datë 19.04.2024 dhe nr.139/1 prot, datë25.03.2024 të Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njesisë së Kavajës, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike Gjithashtu, në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 41/4 b i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

g) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

h) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

i) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

j) Në rastin e procedurës së prokurimit *“Shërbim konsulence”*, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

2.3.4: Autodeklarate nga ofertuesi që të gjitha materialet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të certifikuara (CE).

Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 dhe 2 gj) te nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1: (nuk është i aplikueshëm).

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për keto pika do të jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose Ekuivalente”.

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

✚ Loti 1: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)" në Q.S.R.T. "Shefqet Ndroqi", Njësia Tiranë

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	sasia
1	F.v. elektromotorri krevati tip erpa	Copë	20
2	F.v. Pult krevati tip erpa	Copë	100
3	Riparim – mirembajtje freni	Copë	16
4	Riparim–mirembajtje i suportit metalik ballor te krevatit tip erpa	Copë	10
5	Riparim - mirembajtje krevati(defekte te ndryshme)	Copë	40
6	Riparim karroce pacienti	Copë	20
7	Riparim mirembajtje barrele pacienti te autoambulancave	Copë	10
8	F.V. rrota krevatesh tip erpa	Copë	40
9	Riparim – mirembajtje tavoline ngrënie pacienti	Copë	85
10	F.v. elektromotorri krevati tip SCHRODER	Copë	8

11	F.v. Pult krevati tip SCHRODER	Copë	12
12	Riparim - mirembajtje krevate tip SCHRODER	Copë	6
13	F.V. rrota krevatesh tip SCHRODER	Copë	20

Specifikimet Teknike të Përgjithshme

Krevate TIP ERPA

- Pulti të jetë me butona, kabëll me elasticitet të lartë dhe dimensione 172*55mm
- Elektromotorri të ketë dimensione 707*167*121 mm
- Forca e shtytjes të jetë 2*6500 N
- Shpejtësia e ulje-ngritjes të jetë deri 4.3 mm/second
- Elektromotorri dhe pultet të jenë për krevat Tip ERPA ose ekuivalent

Krevate TIP SCHRODER

- Elektromotorri të ketë dimensione 373*200 mm
- Pultet të jenë me 8 butona
- Forca e shtytjes të jetë 3*3000N(me 3 motorra)
- Shpejtësia e ulje ngritjes të jetë deri në 4.5 mm/second
- Për krevatet tek reanimacioni pultet duhet të jenë Tip Schroder ose ekuivalent

Specifikime teknike të tjera

- Riparim mirembajtja do te behet sipas grafikut te punimeve te hartuar nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, me perjashtim te rasteve emergjente.
 - Riparim mirembajtja do te kryhet brenda orarit zyrtar te punes, per rastet emergjente ne cdo ore.
 - Ne fund te muajit mbahet dhe procesverbali i marrjes ne dorezim te riparim mirembajtjes mes paleve.
 - Ne fillim te zbatimit te kontrates O.E fitues prezanton stafin teknik si dhe mbahet nje proces – verbal per fillimin e riparim – mirembajtjes.
 - Ne fund te muajit mbahet dhe situacioni mujor qe i bashkelidhet fatures.
 - Per cdo furnizim vendosje O.E do te ofroje garanci per nje periudhe 6 mujore.
 - Nga O.E. fitues do te kerkohet mirembajtja dhe riparimi i tyre ne cdo moment qe pesojne difekt gjate 24/7.
 - O.E. fitues do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.
 - I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.
 - I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjate kryerjes se shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje.
 - Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe jo më shumë 3 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.
 - Njoftimi bëhet me sms nga ndjekesi i kontratës.

Në respektim të Nenit 4/7 të LPPse, si dhe nenit 36/3 dhe 4 te LPPse NR. 162/2020, ne të gjitha rastet kur përmendet "markë" përfshihet termi "ekuivalent".

Loti 2: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Kavajë:

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.V. i struktures se rrotes se krevatit te pacientit (rrota frenuese)	Copë	40
2	F.V. i struktures se rrotes se krevatit te pacientit (rrota te thjeshta)	Copë	40
3	Saldim te shtratit te krevatit te pacientit	Copë	12
4	Lyerje komplet te shtratit te pacientit	Copë	12
5	Riparim komplet tavoline ngrënie te pacientit	Copë	14
6	Riparim komplet komedine te pacientit	Copë	24
7	Riparim karroce te pacientit	Copë	5
8	Riparim i shtratit te pacientit	Copë	4
9	Riparim i rrotave te shtratit te pacientit	Copë	14
10	Riparim tavolina per shperndarjen e ushqimit (me rrota te levizshme)	Copë	4
11	Riparim i barrelave te pacientit	Copë	2
12	Riparim i rafteve te pacientit (teke)	Copë	6
13	Riparim i rafteve te pacientit (dyshe)	Copë	4

Specifikime teknike të tjera

- Riparim mirembajtja do te behet sipas grafikut te punimeve te hartuar nga Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, me perjashtim te rasteve emergjente.
- Riparim mirembajtja do te kryhet brenda orarit zyrtar te punes, per rastet emergjente ne cdo ore.
- Ne fund te muajit mbahet dhe proces verbali i marrjes ne dorezim te riparim mirembajtjes mes paleve.
- Ne fillim te zbatimit te kontrates O.E fitues prezanton stafin teknik si dhe mbahet nje proces – verbal per fillimin e riparim – mirembajtjes.
- Ne fund te muajit mbahet dhe situacioni mujor qe i bashkelidhet fatures.
- Per cdo furnizim vendosje O.E do te ofroje garanci per nje periudhe 6 mujore.
- Nga O.E fitues do te kerkohet mirembajtja dhe riparimi i tyre ne cdo moment qe pesojne difekt gjate 24/7
- O.E. fitues do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.
- I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.
- I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbi mit gjate kryerjes se shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje.
- Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur

pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe jo më shumë 3 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

- Njoftimi behet me sms nga ndjekesi i kontrates.

Në respektim të Nenit 4/7 të LPPse, si dhe nenit 36/3 dhe 4 te LPPse NR. 162/2020, në të gjitha rastet kur përmendet "markë" përfshihet termi "ekuivalent".

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Sasia e shërbimit që kërkohet: Sasitë e parashikuara janë orientuese dhe sipas nevojave dhe Kërkesave të AK.

Afatet e ekzekutimit:

- ✚ **Loti 1 : Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi”Njësia Tiranë**

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.v. elektromotorri krevati tip erpa	Copë	20
2	F.v. Pult krevati tip erpa	Copë	100
3	Riparim – mirembajtje freni	Copë	16
4	Riparim–mirembajtje i suportit metalik ballor te krevatit tip erpa	Copë	10
5	Riparim - mirembajtje krevati(defekte te ndryshme)	Copë	40
6	Riparim karroce pacienti	Copë	20
7	Riparim mirembajtje barrele pacienti te autoambulancave	Copë	10
8	F.V. rrota krevatesh tip erpa	Copë	40
9	Riparim – mirembajtje tavoline ngrënie pacienti	Copë	85
10	F.v. elektromotorri krevati tip SCHRODER	Copë	8
11	F.v. Pult krevati tip SCHRODER	Copë	12
12	Riparim - mirembajtje krevate tip SCHRODER	Copë	6

Afatet e ekzekutimit: Nga data e nënshkrimit të MK, MiniKontratat do të lidhen deri ne 2vite(2 4muaj),sipas nevojave të Autoritetit tonë Kontraktor, çdo 4 muaj, përgjatë 24 muajve.

- ✚ **Loti 2: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate,tavolina ngrënie,karroce pacienti dhe barrele)” në Q.S.R.T. “Shefqet Ndroqi”Njësia Kavajë.**

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.V. i strukturës së rrotës së krevatit të pacientit (rrota frenuese)	Copë	40
2	F.V. i strukturës së rrotës së krevatit të pacientit (rrota të thjeshta)	Copë	40
3	Saldim të shtratit të krevatit të pacientit	Copë	12
4	Lyerje komplet të shtratit të pacientit	Copë	12
5	Riparim komplet tavoline ngrenie të pacientit	Copë	14
6	Riparim komplet komedine të pacientit	Copë	24
7	Riparim karroce të pacientit	Copë	5
8	Riparim i shtratit të pacientit	Copë	4
9	Riparim i rrotave të shtratit të pacientit	Copë	14
10	Riparim tavolina për shpërndarjen e ushqimit (me rrota të levizshme)	Copë	4
11	Riparim i barrelave të pacientit	Copë	2
12	Riparim i rafteve të pacientit (teke)	Copë	6
13	Riparim i rafteve të pacientit (dyshe)	Copë	4

Afatet e ekzekutimit: Nga data e nënshkrimit të MK, MiniKontratat do të lidhen deri në 2vite(2 4muaj),sipas nevojave të Autoritetit tonë Kontraktor, çdo 4 muaj, përgjatë 24 muajve.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Tiranë, me afat 24 muaj dhe Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Kavajë, me afat 24 muaj, e ndarë në 2 lote - Marrëveshje kuadër me disa Operatorë Ekonomikë (një operator ekonomik të suksesshëm për secilin lot), ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj”.

Detyrat: Operatori Ekonomik duhet të paraqitet sa herë merr njoftime nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të nevojave të këtij të fundit.

Shpërndarja: Kontratat e riparim mirëmbajtjes do të lidhen çdo 4 muaj dhe sipas nevojave të AK përgjatë 24 muajve.

Lot 1: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti, karrocë ambulance dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Tiranë:

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.v. elektromotorri krevati tip erpa	Copë	20
2	F.v. Pult krevati tip erpa	Copë	100
3	Riparim – mirembajtje freni	Copë	16
4	Riparim–mirembajtje i suportit metalik ballor te krevatit tip erpa	Copë	10
5	Riparim - mirembajtje krevati(defekte te ndryshme)	Copë	40
6	Riparim karroce pacienti	Copë	20
7	Riparim mirembajtje barrele pacienti te autoambulancave	Copë	10
8	F.V. rrota krevatesh tip erpa	Copë	40
9	Riparim – mirembajtje tavoline ngrënie pacienti	Copë	85
10	F.v. elektromotorri krevati tip SCHRODER	Copë	8
11	F.v. Pult krevati tip SCHRODER	Copë	12
12	Riparim - mirembajtje krevate tip SCHRODER	Copë	6
13	F.V. rrota krevatesh tip SCHRODER	Copë	20

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”/ Njësia Tiranë,

Adr.: Rr. “Dr. Shefqet Ndroqi”, Sauk, Tiranë.

Loti 2: Riparim - mirëmbajtje Hotelerie (krevate, tavolina ngrënie, karroce pacienti dhe barrele)” në QSRT “Shefqet Ndroqi”, Njësia Kavajë:

Nr.	Emërtimi i Përgjithshëm	Njësia	SASIA
1	F.V. i struktures se rrotes se krevatit te pacientit (rrota frenuese)	Copë	40
2	F.V. i struktures se rrotes se krevatit te pacientit (rrota te thjeshta)	Copë	40
3	Saldim te shtratit te krevatit te pacientit	Copë	12
4	Lyerje komplet te shtratit te pacientit	Copë	12
5	Riparim komplet tavoline ngrënie te pacientit	Copë	14
6	Riparim komplet komedine te pacientit	Copë	24
7	Riparim karroce te pacientit	Copë	5
8	Riparim i shtratit te pacientit	Copë	4
9	Riparim i rrotave te shtratit te pacientit	Copë	14
10	Riparim tavolina per shperndarjen e ushqimit (me rrota te levizshme)	Copë	4
11	Riparim i barreleve te pacientit	Copë	2
12	Riparim i rafteve te pacientit (teke)	Copë	6
13	Riparim i rafteve te pacientit (dyshe)	Copë	4

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

**Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”/ Njësia Kavajë,
Adr.: Rr. “Qazim Kariqi”, lagjja nr. 2, Kavajë.**

NJËSIA E PROKURIMIT